



Projekti: “Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri”

Projekti ndihmon qytetarët shqiptarë që të gjejnë dhe regjistrojnë premtimet elektorale të politikanëve shqiptarë. Projekti ofron mjete dhe mundësi për të verifikuar realizimin e këtyre premtimeve.

Qëllimi është që të mbahen nën përgjegjësi lidhur me premtimet deputetët e parlamentit shqiptar dhe të zgjedhurit lokalë, kryetarët e Bashkive.

Këtij qëllimi i shërben përgatitja e buxheteve qytetare, që janë versione të thjeshtuara të buxheteve bashkiake për vitin 2020. Nëpërmjet këtyre buxheteve qytetarët do të kuptojnë më mirë mënyrën e shpenzimeve dhe se si shpenzohen taksat e tyre.

Ju lutemi të gjeni në këtë dokument buxhetin e thjeshtuar qytetar të Bashkisë Gjirokastrë.

Ju falenderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin!

Buxheti Qytetar i Bashkisë Gjirokastër, Viti 2020:

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë parashikimin për të ardhurat e vitit 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.


Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë.

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve, /000 lek

Burimet e financimit	Viti 2019	Viti 2020	Diferenca 2020-2019
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	205,772 (35%)	210,664 (35.2%)	4,892
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	172,642 (30%)	174,477 (29%)	1,835
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	199,318 (34.3%)	209,284 (35%)	9,966
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	3,689 (0.6%)	3,873 (0.6%)	- 184
Total	581,421	598,298	16,877


Burimi: Bashkia Gjirokastër, 2020, llogaritje EIC

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Gjirokaštër 2019




Burimi: Bashkia Gjirokaštër (llogaritje EIC)

Figura 2. Të ardhurat totale, Bashkia Gjirokaštër 2020



Burimi: Bashkia Gjirokaštër, 2020, llogaritje EIC

Figura 3. Të ardhurat totale për vitet 2019-2020



Burimi: Bashkia Gjirokastrë, 2020, llogaritje EIC

Më poshtë është dhënë parashikimi mbi të ardhurat nga taksat dhe tarifatat, duke zbritur të ardhurat nga gjobat, institucionet e varësisë dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia.

Tabela 2. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat

Njësia vendore	Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat 2020
Bashkia Gjirokastrë	209,284 (të ardhurat pa gjobat dhe të ardhurat e tjera vendore)
	Të ardhurat vendore
	213,157

Burimi: Bashkia Gjirokastrë 2020

Tabela 3. Lista e taksave vendore (detyrime që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

(Bilanci 2019 është i pritshëm, pasi sipas Ligjit mbi dorëzimet e bilanceve, bilanci i mbyllur i vitit 2019 dorëzohet deri më 31 Mars 2020. Më pas del vlera reale).

Nr.	Taksat vendore	Plani i pritshëm 2019 në /000 Lekë	Plani 2020	Diferenca 2020-2019 në 000/Lekë	Diferenca në % 2020-2019	% mbi tot. e të ardhurave vendore
1	Taksa mbi ndërtesat	36,439	38,261	1,822	5	17.9
2	Taksa mbi tokën bujqësore	7,553	7,931	378	5	3.7
3	Taksa e fjetjes në hotel	1,011	1,062	51	5	0.5
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë ndërt.reja	16,538	17,364	827	5	8.1
5	Taksa e kalim drejt.pronesisë pasuritë e palujt.	1,327	1,394	66	5	0.7
6	Taksa vjetore mjeteve të përdorura	14,347	15,064	717	5	7.1
7	Taksa për zënieën e hapsirave publike	1,689	1,773	84	5	0.8
8	Taksa të përkohshme	662	695	33	5	
9	Të tjera	677	711	34	5	0.3
	TOTALI	80,242	84,254	4,012	5	39.5

Burimi: Bashkia Gjirokastrë (llogaritje EIC)

Tabela 4. Lista e tarifave vendore (detyrime fikse që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

Nr.	Tarifat vendore	Plani i pritshëm 2019 në 000/Lekë	Plani 2020	Diferenca 2020-2019 në 000/Lekë	Diferenca në % 2020-2019	% mbi tot. e të ardhurave vendore
1	Tarifa për pastrim	44,101	46,306	2,205	5	22
2	Tarifa e ndriçimit rrugor	28,184	29,594	1,409	5	14
3	Tarifë gjelbërimi	3,052	3,204	153	5	2
4	Tarifa për reklamë	5,730	6,016	286	5	3
5	Tarifa parkimi	3,133	3,290	157	5	2
6	Tarifa për therrjen e bagëtive	194	204	10	5	0
7	Tarifa shërbime sociale (arsim parashk.konvikte)	8,595	9,025	430	5	4
8	Sporte dhe kultura	5,982	6,281	299	5	3
9	Tarifa të tjera	20,104	21,109	1,005	5	10
10	Tarifa për pastrim	44,101	46,306	2,205	5	22
	TOTALI	119,076	125,029	5,954	5.0	59


Burimi: Bashkia Gjirokastrë (llogaritje EIC)

Tabela 5 Lista e të ardhurave të tjera vendore (të ardhura nga shërbimet që ofron Bashkia/gjyba dhe institucionet vartëse)

Nr.	Të ardhura të tjera vendore	Plani i pritshëm 2019 në 000/Lekë	Plani 2020	Diferenca 2020-2019 në 000/Lekë	Diferenca në % 2020-2019	% mbi tot. e të ardhurave vendore
1	Qera trualli	335	352	17	5	0
2	Qera nga ndërtesat	3,353.8	3,521.50	168	5	2
	TOTALI	3,689	3,873	184	5	2


Burimi: Bashkia Gjirokastrë (llogaritje EIC)

Figura 4. Të ardhurat vendore në vlerë 2019-2020




Burimi: Bashkia Gjirokastrër (llogaritje EIC)

Figura 5. Të ardhurat vendore si % mbi totalin e të ardhurave vendore



Burimi: Bashkia Gjirokastrër (llogaritje EIC)

Figura 6. Diferenca e të ardhurave vendore



Burimi: Bashkia Gjirokastrë (llogaritje EIC)

Një element tjetër i rëndësishëm për të ardhurat në buxhetin e bashkive është edhe transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike, e cila ndihmon ndjeshëm njësitë vendore në përmbushjen e planeve të investimeve dhe shpenzimeve.

Tabela 5. Transfertat qeveritare (fonde të deleguara nga Qeveria për Bashkitë)

Emërtimi	2020	% mbi Tot. Ardh.
Transferta e pakushtëzuar	210,664	(35.2%)
Transferta specifike	174,477	(29%)

Burimi: Bashkia Gjirokastrë (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Gjirokastrër për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 6. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2019 në 000/Lekë	Viti 2020 në 000/Lekë	Diferenca në vlerë në 000/Lekë	Diferenca në %	% mbi Tot. Ardh.
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	441,977	406,128	-35,849	-8.1	67.9
Shpenzime Korrente	130,242	175,896	45,654	35.1	29.4
Shpenzime për Investime	92,571	112,267	19,696	21.3	18.8
TOTAL	664,790	694,291	29,501	4.4	116.0


Burimi: Bashkia Gjirokastrër (Ilogaritje EIC)

Figura 7 Diferenca e shpenzimeve për vitin 2019-2020



Burimi: Bashkia Gjirokastrër (Ilogaritje EIC)

Figura 8 Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Gjirokastrë (llogaritje EIC)

Më poshtë po japim shpenzimet e Bashkisë sipas Programeve:

Tabela 7. Shpenzimet sipas programeve dhe si % ndaj Tot.të ardh.vendore

Shpenzimet Bashkia Gjirokastrë	Vlera	% ndaj TA vendore
Administrata Bashkia/Njësitë Administrative	129,501	21.6
Agjencia e të Ardhurave	27,089	4.5
Agjencia e Shërbimit Publik	9,370	1.6
Menaxhimi Rrugor/rrugët rurale	18,616	3.1
Ndriçimi Publik	7,579	1.3
Mbrojtja e mjedisit	10,212	1.7
Emergjencat Civile	552	0.1
Menaxhimi i mbetjeve dhe shërbimet publike vendore	133,600	22.3
Zhvillimi i Sporti	5,107	0.9

Arti, Kultura dhe Turizmi	51,217	8.6
Shërbimi social	3,238	0.5
Agjencia e Mirëqënies dhe Kujdesit Social	23,727	4.0
ASHBVM	2,572	0.4
Arsimi Parashkollor	123,130	20.6
Arsimi Paraunivers. + Konviktet e arsimit paraunivers.	36,359	6.1
Ujitja dhe kullimi	14,672	2.5
Shërbimi zjarrfikës	35,008	5.9
Administrimi i Pyjeve	11,586	1.9
Rrugët Rurale	51,156	8.6
Total	694,291	116.0

Burimi: Bashkia Gjirokastrë (llogaritje EIC)